

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar në Kreun V të Ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Garda e Republikës shpall procedurat e aplikimit për:

- 1 vend i lirë pune, për punonjës të nivelit të lartë;
- 6 vende të lira pune, për punonjës të mesëm, grada Nënkomisar deri në Kryekomisar;
- 19 vende të lira pune, për punonjës të nivelit bazë, grada inspektor.

Kandidatët duhet të jenë ish punonjës të Gardës ose të strukturave të tjera me gradë (Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, Policia e Burgjeve, etj).

I. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR PUNONJËS TË NIVELIT TË MESËM DHE BAZË:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;
- ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm (për kandidatët e nivelit bazë) dhe arsimin e lartë ushtarak ose policor (për kandidatët e nivelit të mesëm);
- d) të jetë i moshës 19-40 vjeç (për kandidatët e nivelit bazë);
- dh) të jetë me gjatësi trupore jo më pak se 175 cm (për kandidatët e nivelit bazë);
- e) të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbim në struktura që, sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë;
- ë) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- f) të mos jetë në ndjekje penale;
- g) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore;
- gj) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një prej kriterëve të mësipërme, nuk kualifikohet dhe nuk mund të vazhdojë konkurrimin.

II. DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT:

Kandidatët që aplikojnë për punonjës të nivelit të mesëm dhe bazë duhet të paraqesin në fazën e parë të konkurimit dokumentet e mëposhtëm:

- a) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur vakant;
- b) Jetëshkrim (CV);
- c) Kopje të kartës së identitetit;
- ç) Dëftesën e shkollës së mesme ose listë notash, të cikluar në Drejtorinë Arsimore të

rrethit, të fotokopjuar dhe të noterizuar;

d) Diplomën e arsimit të lartë (për kandidatët e nivelit të mesëm);

dh) Vërtetim nga Gjykata;

e) Vërtetim nga Prokuroria;

ë) Raport i aftësisë në punë (sipas shtojcës V, të VKM nr.596, datë 4.9.2019), nga mjeku i familjes;

f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;

g) Vërtetim për vjetërsinë e shërbimit dhe motivacionin e largimit nga strukturat e tjera me gradë (policia e shtetit, forcat e armatosura, policia e burgjeve etj);

Gj) Dy foto (9 X 12) me kostum dhe kollare.

Dokumentet dorëzohen në adresën: “Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, pranë Pallatit të Brigadave, Tiranë, ose duke u paraqitur personalisht në ambientet e Gardës.

Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumenteve është **brenda datës 18.12.2024.**

Kandidati do t’i nënshtrohet intervistës dhe vlerësimit psikologjik, ditën e dorëzimit të dokumenteve.

III. SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCESI I ANKIMIMIT

Afati i shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit është 3 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit. Kandidati që nuk plotëson kriteret dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit, skualifikohet dhe do të njoftohet individualisht për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail ose me telefon).

Kandidati ka të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes. Komisioni i Apelimit shqyrton ankesat dhe kthen përgjigje brenda 2 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

IV. TESTIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët e kualifikuar në fazën e dorëzimit dhe kontrollit të dokumenteve, duhet të paraqiten **në orën 08:00 të datës 23.12.2024**, në adresën: Qendra e Aftësimit Profesional të Gardës së Republikës, Mullet, Tiranë, për t’iu nënshtuar testimit fizik. Kandidati që nuk paraqitet në kohë për testimin e aftësive fizike, skualifikohet.

Aplikanti skualifikohet kur nuk kalon me suksese njërin prej komponentëve të mëposhtëm të vlerësimit:

- testi psikologjik;
- testi i aftësive fizike.

V. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët kalojnë testimin e aftësive fizike nëse arrijnë rezultatin minimal 50 pikë. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas rendit zbritës të pikëve, nga rezultati më i lartë në atë më të ulët.

Komponentët e vlerësimit për testimin e aftësive fizike janë sipas lidhjes nr. 2.

VI. KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË KONKURRIMIT

Në përfundim të të gjithë procedurës së konkurrimit dhe vlerësimit të kandidatëve, të gjithë kandidatët fitues, do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (e-mail personal) ose me telefon nga Garda e Republikës.

Lidhja nr.2

Nr	ELEMENTËT TESTUES	PËR SASINË/ KOHEN		PIKËT	VLERËSIMI I REZULTATIT
		Meshkuj	Femra		
1	Ulje – ngritje me forcën e krahëve (pompa) për kohën 2’.	45	15	25	Shkëlqyeshëm
		43	13	23	Shumë mirë
		40	10	20	Mirë
		37	8	17	Kënaqshëm
		35	7	15	Mjaftueshëm
		33	6	13	Minimal
		nën.33	nën.06	12	Dobët
2	Palosje – shpalosje me Muskujt e barkut për Kohën 2’.	45	15	25	Shkëlqyeshëm
		43	13	23	Shumë mirë
		37	10	20	Mirë
		35	7	17	Kënaqshëm
		33	6	15	Mjaftueshëm
		30	5	13	Minimal
		nën.30	nën.05	12	Dobët
3	Tërheqje në hekur	10	4	25	Shkëlqyeshëm
		8	3	23	Shumë mirë
		7	2	20	Mirë
		5	1	17	Kënaqshëm
		4	1	15	Mjaftueshëm
		3	1	13	Minimal
		nën.03	0	12	Dobët
4	Vrapim rezistence 3000 m me uniformë sportive.	15’	17’30’’	25	Shkëlqyeshëm
		15’ 20’’	18’	20	Shumë mirë
		15’ 40’’	18’30’’	15	Mirë
		16’	19’	13	Kënaqshëm
		16’ 20’’	19’30’’	10	Mjaftueshëm
		16’ 40’’	19’ 50’’	8	Minimal
		mbi 16’ 40’’	mbi 19’ 50’’	7	Dobët